




REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

---

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**

---

Më 13. 08. 2020

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Vushtrrisë, shpall konkurs letrar të poezisë për Festivalin:

**“TAKIMET E POETESHAVE SHQIPTARE 2020”**

Këtë vit, në Vushtrri, do të mbahet Edicioni 38 i Festivalit “Takimet e Poeteshave Shqiptare 2020”, në të cilën inkurajohen, që me poezitë e tyre të konkurrojnë të gjitha krijueset shqiptare nga të gjitha trojet shqiptare, përfshirë edhe poetet nga mërgata.

**Qëllimi i konkursit**

- Ruajtja, kultivimi dhe zhvillimi i kulturës dhe letrave shqipe të femrat shqiptare;
- Nxitja, motivimi dhe promovimi i krijueseve shqiptare.

**Kushtet për pjesëmarrje**

- Poetet të konkurrojnë me emër dhe mbiemër dhe të jenë të moshës mbi 18 vjeçe,
- Poetet të konkurrojnë vetëm me nga një poezi,
- Format i shkronjave duhet të jetë: Microsoft Word, Time New Roman, 12,
- Poezitë duhet të jenë në gjuhën shqipe, të pabotuara më parë.
- Poezitë të dërgohen vetëm përmes postës elektronike në adresën **poetetshqiptare@gmail.com** (Secilës poete i konfirmohet pranimi i poezisë përmes postës elektronike).
- Poetet, së bashku me punimet e tyre t’i dërgojnë: dy numra kontakti (të qasshëm në çdo kohë), një biografi të shkurtër të krijimtarisë së poetes dhe një fotoportret.
- 21 poeteshat që do të përzgjidhen për të vazhduar në fazën e dytë të konkurrimit do të njoftohen me kohë për detajet tjera rreth lidhje me organizimin e Festivalit.

## Afati i dërgimit

- Afati i dërgimit të poezive është i hapur **15 ditë**, nga dita e shpalljes.

Poezitë e arritura do të grumbullohen në dosje, pa të dhëna të autorësisë dhe vetëm me shifër, të cilën secilës poezi ia vendosë zyrtari i DKRS-së. Poezitë do të vlerësohen nga juria profesionale, e cila do të bëjë leximin dhe vlerësimin e poezive, pa pasur dijeni mbi autoren, por vetëm në bazë të shifrës, të cilën ia vendosë zyrtari i DKRS-së. Juria do të përmbyllë procesin e vlerësimit para datës së mbajtjes së festivalit, ndërsa ndarja e çmimeve do të bëhet në ditën e mbajtjes së festivalit. Për pjesëmarrje në festival do të kontaktohen vetëm poetet, poezitë e të cilave janë për zgjedhur për të vazhduar në fazën e dytë të konkurrimit.

Poetet që do të vazhdojnë konkurrimin do të njoftohen përmes telefonit pas vlerësimit të poezive nga ana e jurisë profesionale, ndërsa ato poete që nuk ftohen do të thotë që poezitë e tyre nuk janë për zgjedhur nga juria për të vazhduar në tutje.

Në këtë festival do të ndahen këto çmime për poezi:

Çmimi i parë.....	500 €
Çmimi i dytë .....	300 €
Çmimi i tretë .....	200€
Debutuesja (poetja më e re në moshë).....	100 €

Për të gjitha poetet, poezitë e të cilave do të përzgjidhen nga juria, për pjesëmarrje në festival, organizatori mbulon shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit.

Për informata më të hollësishme mund të shkruani në e-mail adresën e lartshënuar.

Drejtoreshë e DKRS-së

Fatmire Cecelia

